K Ë R K E S Ë

Kërkuese: Sheqere Koçi e bija e Abdurrahimit dhe e Vahide lindur më 1951 në Peshkopi, banuese në Tiranë në rrugën "Vllazën Huta" nr.16.

Objekti: Kërkoj shpalljen e vdekjes të Vahide Koçit.

Baza ligjore: Neni 375 të Kodit të Procedurës Civile

Unë kërkuesja Sheqere Koçi, në bazë të çertifikatës së trungut familjar, jam e bija e të ndjerës Vahide Koçi. Theksoj se mamaja ime ka vdekur më datë 28 shkurt 1985 në fshatin Lejcan të rrethit të Peshkopisë, e cila kishte vajtur për të parë djalin e saj që jetonte atje. Për shkak të kohës së keqe ceremonia e varrimit iu bë në fshat. Nga verifikimet që kemi bërë në Gjendjen Civile të Njësisë nr.2 në Tiranë, rezulton se e ndjera Vahide Koçi nuk ka vdekur por është e gjallë. Këtë e vërtetojmë në bazë të çertifikatës së lindjes, e cila është marrë nga Zyra e Gjendjes Civile.

Prandaj në këto kushte po i drejtohemi gjykatës me anën e kësaj kërkese për shpalljen të vdekur të së ndjerës Vahide Koçi në bazë të nenit 375 të K.Pr.Civile.

Bashkëngjitur kësaj kërkese do t'iu paraqesim dhe provat e nevojshme si dhe dëshmitarët për këtë çështje.

KËRKUESJA
Sheqere Koçi